



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.55

6 maj

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendimi KM nr.419, datë 30.4.2009	Për procedurat e pajisjes së shtetasve pa pasaportë, që nuk përfitojnë kompensim nga vendimi nr.366, datë 15.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë”	2563
Vendim i KNSH nr.29, datë 8.4.2009	Për përcaktimin e normës së interesit për kthimin e ndihmës shtetërore, për vitin 2009	2566
Vendim i KNSH nr.30, datë 8.4.2009	Për miratimin e “Hartës së ndihmës shtetërore”	2566
Vendim i KKRT nr.788, datë 27.3.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kombëtar “TV Klan”	2586
Vendim i KKRT nr.789, datë 27.3.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Egnatia”	2586
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Veri Dika, dhe caktimin si kujdestare për administrimin e pasurisë, gruan e tij, Trëndeline Dika.....	2586

VENDIM
Nr.419, datë 30.4.2009

PËR PROCEDURAT E PAJISJES SË SHTETASVE PA PASAPORTË, QË NUK PËRFITOJNË KOMPENSIM NGA VENDIMI NR.366, DATË 15.4.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KOMPENSIMIN E PAGESËS PËR PAJISJEN ME LETËRNJOFTIM TË SHTRESAVE NË NEVOJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjithë shtetasit, që mbushin moshën 18 vjeç deri më datën 28 qershor 2009 dhe që nuk kanë pasaportë, si dhe nuk përfshihen në skemën e kompensimit, të parashikuar në vendimin nr.366, datë 15.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë”, mund të aplikojnë, duke paguar paraprakisht një tarifë prej 200 (dyqind) lekësh, deri më 18 qershor 2009.

2. Rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, zbatohet edhe për të gjithë shtetasit, që votojnë për herë të parë dhe që kanë lindur në periudhën 19.2.1989-28.6.1991, siç përcaktohet në nënndarjen “iv” të shkronjës “b” të pikës 1 të vendimit nr.366, datë 15.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë”, por që nuk ndjekin shkollat publike.

3. Shtetasit e përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, pajisen me kuponët në zyrat postare përkatëse të njësive të qeverisjes vendore pas pagimit të tarifës prej 200 (dyqind) lekësh. Në rast se njësia e qeverisjes vendore ka më shumë se një zyrë postare, pajisja bëhet në zyrën kryesore postare të njësisë, së cilës, nga Ministria e Brendshme, i vihet në dispozicion lista emërore e shtetasve, që nuk kanë pasaportë.

4. Kur shtetasi nuk është i përfshirë në listën e shtetasve pa pasaportë, mund të pajiset nga zyra postare me kuponin vetëm nëse:

a) paraqet një vërtetim nga Policia e Shtetit se nuk ka pasaportë, në përputhje me pikën 8/1 të vendimit nr.1, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim, të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, të ndryshuar ose;

b) nënshkruan formularin e deklarimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, ku përfshihet edhe deklarata se nuk ka pasaportë, nuk ka përfutur kupon nga ndonjë skemë kompensimi dhe se mban përgjegjësi penale sipas nenit 144 të Kodit Penal.

Formulari i deklarimit ose vërtetimi i lëshuar nga Policia e Shtetit dorëzohen në zyrën e postës në çastin e dhënies së kuponit, të vulosur me vulën e postës. Ky kupon mund të përdoret për aplikim vetëm nga shtetasi përfitues, sipas këtij vendimi. Formularët e deklarimit, të nënshkruara, dhe vërtetimet e lëshuara nga Policia e Shtetit administrohen nga Ministria e Brendshme.

5. Vlera e mbetur prej 1000 (një mijë) lekësh duhet të paguhet nga personat përfitues, sipas këtij vendimi, brenda 6 muajve nga data e aplikimit. Paga kryhet pranë zyrave postare, për llogari të Buxhetit të Shtetit. Në rast se personi nuk kryen pagesën për shumën e mbetur brenda periudhës 6-mujore, shpallet debitor dhe vjelja e detyrimit bëhet sipas procedurave përkatëse.

Personat, që përfitojnë sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, përjashtohen nga zbatimi i këtij detyrimi, nëse paraqesin dokumentet e aplikimit, sipas shkronjës “dh” të pikës 4 të vendimit nr.366, datë 15.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë”.

6. Rregullat e hollësishme dhe mënyra e pagesës së kompensimit të Postës Shqiptare sh.a. për çmimin e letërnjoftimit, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

7. Zyrat e aplikimit të mos pranojnë aplikime në periudhën 18.6.2009-30.6.2009. Në këtë periudhë zyrat qëndrojnë të hapura vetëm për shpërndarjen e letërnjoftimeve.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen brenda fondit të përcaktuar në pikën 7 të vendimit nr.366, datë 15.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë”.

9. Shkronja “dh” e pikës 4 të vendimit nr.366, datë 15.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë”, nuk zbatohet për kategorinë e shtetasve të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR
VETËDEKLARIMI PËR PAJISJE ME LETËRNJOFTIM

Të dhëna personale				
Emri	Mbiemri	Atësia	Vendbanimi	Dokument identifikimi

Kategoria e personit përfitues
Person pa pasaportë dhe që nuk e ka emrin në listën e shtetasve që nuk kanë pasaportë.

Marrje përsipër përgjegjësie për të dhëna të rreme
Deklaroj me përgjegjësinë time të plotë ligjore se nuk disponoj pasaportë dhe/ose nuk kam përfituar kupon nga asnjë skemë kompensimi për efekt aplikimi për letërnjoftim. Pranoj se çdo deklaram i rremë për sa më sipër përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 4 vjet sipas nenit 144 të Kodit Penal.

Data:

Emër/Mbiemër/

Firmë

VENDIM
Nr.29, datë 8.4.2009

PËR PËRCAKTIMIN E NORMËS SË INTERESIT PËR KTHIMIN E NDIHMËS
SHTETËRORE, PËR VITIN 2009

Në mbështetje të nenit 17 shkronja “d” të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” dhe të nenit 15 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005, Komisioni i Ndihmës Shtetërore

VENDOSI:

1. Norma e interesit për kthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme, për vitin 2009 do të jetë në masën 8,74%.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM
Nr.30, datë 8.4.2009

PËR MIRATIMIN E “HARTËS SË NDIHMËS SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 17 shkronja “ç” të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” dhe të nenit 5, pika 2 dhe 3, të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.816, datë 28.12.2005, Komisioni i Ndihmës Shtetërore

VENDOSI:

1. Miratimin e “Hartës së ndihmës shtetërore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

HARTA E NDIHMËS SHTETËRORE

1. Hyrje

Në kuadër të MSA-së¹ dhe Marrëveshjes së ndërmjetme², duhet të përgatitet harta rajonale për ndihmën shtetërore. Konkretisht neni 71 pika 7 paragrafi “b” i MSA-së përcakton:

Brenda pesë viteve që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do t’i paraqesë Komisionit të Komuniteteve Europiane shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar me nivelin NUTS II. Më pas, autoriteti i përmendur në paragrafin 4³ dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane vlerëson bashkërisht kriteret për pranueshmërinë e zonave të Shqipërisë, si dhe intensitetin maksimal të ndihmës në lidhje me to, në mënyrë që të hartohet harta rajonale e ndihmave në bazë të direktivave përkatëse të Komunitetit.

Duke pasur parasysh mungesën në Shqipëri të këtyre treguesve sipas nivelit NUTS II, por edhe diferencat e mëdha që ekzistojnë brenda vendit, në periudhën e parë tranzitore është parashikuar një ndarje e zonave mbi bazën e treguesve të disponueshëm statistikorë.

Pra, si objektivi prioritar është përcaktuar harta rajonale, që duhet të miratohet në zbatim të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”⁴, e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.816, datë 28.12.2005, pavarësisht se, sipas nenit 71 pika 7 paragrafi “a” i MSA-së:

“i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë konsiderohet si një zonë e prapambetur”

Neni 5 i rregullores, në pikat 2 dhe 3, parashikon:

2. Intensiteti i ndihmës rajonale nuk duhet të kalojë 50% të ENG-së, me përjashtim të zonave të thella, ku ai mund të arrijë deri në 65% të ENG-së.

3. Kufijtë e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni mund të rriten për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me 15% të vlerës bruto, me kusht që vlera neto e intensitetit të ndihmës të mos kalojë 75%.

Më tej, në shënimin shpjegues theksohet se:

Për zbatimin e kësaj rregulloreje, zonat e thella janë përcaktuar në bazë të raportit të numrit të personave të varfër kundrejt numrit të përgjithshëm të popullsisë (në %), siç është dhënë në hartën e varfërisë dhe pabarazisë në Shqipëri. Çdo vit, Komisioni i Ndihmës Shtetërore, bazuar në të dhënat më të fundit statistikore, do të publikojë zonat me shifrat përkatëse.

Qëllimi i përgatitjes së hartës rajonale që në këtë fazë, ka qenë përcaktimi i atyre zonave që mund të përfitojnë ndihmë shtetërore me një intensitet deri në 65% për ndërmarrjet e mëdha dhe deri në 75% për SME-të, në kushtet kur duhen ngushtuar sa më shumë diferencat që ekzistojnë në zhvillimin ekonomik-shoqëror të zonave të ndryshme, por edhe duke pasur parasysh se mundësitë e buxhetit për mbështetje maksimale në të gjithë vendin janë të kufizuara.

2. Metodologjia

Shqipëria nuk ka një klasifikim statistikor ose rajonal sipas NUTS II⁵, që përbën bazën për hartimin e hartës së ndihmës shtetërore. Përveç kësaj, edhe treguesit në nivel qarku nuk paraqesin të dhënat e PPB-së, që është treguesi kryesor, prej nga merr zanafillën klasifikimi i zonave lidhur me nivelin e tyre ekonomik. Nga ana tjetër, bazuar në nenin 5 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale” nga ana e Komisionit të Ndihmës Shtetërore duhet bërë rregullisht një përditësim i hartës së varfërisë. Në mungesë të kësaj harte, vlerësohet si i domosdoshëm krijimi i hartës së ndihmës shtetërore “Për përcaktimin e zonave thellësisht të prapambetura”, në mënyrë që t’i japë mundësi KNSH-së për të bërë rishikimin e kufijve të intensitetit të lejueshëm të ndihmës.

Lidhur me metodologjinë e ndjekur për përgatitjen e hartës së ndihmës shtetërore, vlerësohen dy momente të rëndësishme:

¹ Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, nënshkruar në Luksemburg, 12 qershor 2006.

² Marrëveshja e ndërmjetme mbi tregtinë dhe çështje të lidhura me tregtinë, midis Komunitetit Europian nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, 22 maj 2006.

³ Autoriteti për kontrollin e ndihmës shtetërore në Republikën e Shqipërisë

⁴ Rregullorja “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, në bazë të nenit 14 pika 2 të ligjit “Për ndihmën shtetërore”.

⁵ NUTS (Nomenklatura për njësitë statistikore territoriale) është një standard i BE-së për ndarjen administrative të vendeve për qëllime statistikore. NUTS gjen rregullim në rregulloren nr.1059/2003 të Parlamentit dhe Këshillit Europian të datës 26 maj 2003 “Mbi krijimin e një klasifikimi të përbashkët e njësisve territoriale për statistikat” OJ L 154, datë 21.6.2003, faqe 1. Nomenklatura e NUTS përdoret nga EUROSTAT si referencë për mbledhjen, zhvillimin dhe harmonizimin e statistikave rajonale të BE-së, si dhe për analizën socio-ekonomike të rajoneve. Rajonet e NUTS II kanë një popullsi midis 800.000 dhe 3 milion banorëve.

Së pari, “raporti i numrit të të varfërve ndaj numrit total të popullsisë (në %)” - si një indikator i prapambetjes social-ekonomik, por jo domosdoshmërisht si tregues i zonave të varfra. Një tregues i mirëfilltë konsiderohet dendësia e vogël e popullsisë.

Së dyti, koncepti i “dhënies së bonusit” (shitesës) të intensitetit të ndihmës në zonat e prapambetura, mbështetur në rregullat e ndihmës rajonale të BE-së. Këtu duhet të merret parasysh klasifikimi në dy kategori - (i) “zona thellësisht të prapambetura” që përkon me përcaktimin e zonave sipas nenit 87(3)(a) të Traktatit dhe (ii) “zona me dendësi të vogël popullore” që përkon me përcaktimin e zonave sipas nenit 87(3)(c) të Traktatit.

Për të mënjeluar përplasjen me legjislacionin shqiptar të termit të prapambetjes, rekomandojmë që nga këndvështrimi i politikës së ndihmës shtetërore, të merret si bazë trajtimi vendas i zonave të prapambetura, sidomos në këtë moment, duke qenë se në të reflektohen koncepti i zonave të thella në përputhje me nenin 87(3)(a) të rregullave të BE-së për zonat e prapambetura.

Në udhëzimin e BE-së për ndihmën rajonale kombëtare për periudhën 2007-2013⁶, ndërmarrjet e mëdha mund të përfitojnë ndihmë me një intensitet maksimal deri në 50%, të shprehur si ENG (ekuivalenti neto i grantit), të cilit mund t’i shtohet edhe 20 % kur përfituesi është ndërmarrje e vogël (ose 10 % në rastin e ndërmarrjeve të mesme).

Metodologjia e propozuar pasqyron frymën e trajtimit të BE-së për zonat e thella (neni 87(3)(a)). Nivelet më të larta të intensitetit të ndihmës për zonat e prapambetura sipas legjislacionit shqiptar (deri në 65% NGE për ndërmarrjet e mëdha dhe 75% NGE për SME-të) janë të pranueshme dhe brenda kufijve të udhëzimit të BE-së për ndihmën rajonale.

Në mungesë të të dhënave të PPB-së në nivel qarku, u caktua që elementi bazë i metodologjisë të jetë përcaktimi i rajoneve të thella të vendit sipas nivelit të prapambetjes ekonomiko-shoqërore. Kështu, krijimi i hartës u mbështet në analizën në nivel qarku (Shqipëria ndahet në 12 qarqe), si dhe në vlerësimin e peshës së treguesve të zhvillimit, bazuar në të dhënat e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal (SNZHR) të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.773, datë 14.11.2007.

Përcaktimi i zonave të prapambetura (disavantazhuara), sipas SNZHR, është kryer në bazë të modelit të vlerësimit të nivelit të zhvillimit ekonomiko-shoqëror, që kryen një indeksim të bazuar në llogaritjen e menduar të disa treguesve statistikorë (indikatorët). Edhe për përgatitjen e hartës rajonale është ndjekur e njëjta logjikë, por pesha e disa prej treguesve në totalin e vlerësimit ka qenë më e lartë. Ndërkohë, analiza është bazuar në vlerësimin e 6 indikatorëve dhe jo 7, sikurse në SNZHR. Për të llogaritur treguesin e zhvillimit, u analizuan të dhënat e nivelit të varfërisë, nivelit të papunësisë, të ardhurat lokale, si dhe aksesit në shërbimet bazë për secilin nga qarqet në raport me mesataren kombëtare. Tabela 1 paraqet treguesit statistikorë të marrë në analizë dhe peshën që zë secili prej tyre në vlerësimin e përgjithshëm.

Tabela 1. Treguesit statistikorë të vlerësuar për përgatitjen e hartës rajonale

	TREGUESIT	Pesha (%)
T1	Niveli i varfërisë	25
T2	Niveli i papunësisë	25
T3	Të ardhurat lokale	15
T4	Niveli i aksesit në furnizimin me ujë	15
T5	Numri i vizitave mjekësore	10

⁶ OJ C 54, 4 mars 2006, parag. 44, 45 dhe 49

T6	Niveli i arsimit të detyrueshëm	10
-----------	--	-----------

Llogaritja e treguesit të zhvillimit, kryhet në bazë të ekuacionit (1) :

$$T_{ZH} = (T_1 + \frac{1}{T_2}) \cdot 0,25 + (T_3 + T_4) \cdot 0,15 + (T_5 + T_6) \cdot 0,10 \quad (1)$$

Sipas kësaj metodologjie, do të konsiderohen më të pazhvilluar qarqet që e kanë TZH-në në vlerat më të ulëta.

Të dhënat kryesore janë marrë nga buletini i Institutit të Statistikave, INSTAT⁷. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë edhe të dhënat e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal (SNZHR), e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.773, datë 14.11.2007.

Në aneks janë paraqitur, në mënyrë të detajuar, të dhënat statistikore të secilit qark, për vitin 2007.

3. Vlerësimi

Në bazë të të dhënave ekonomiko-shoqërore (sipas tabelës 2 në aneks), është përgatitur tabela 3, e cila paraqet nivelin e treguesve në krahasim me mesataren në shkallë vendi, për secilin nga të 12 qarqet, si dhe treguesit përkatës të zhvillimit. Janë konsideruar si qarqe me nivel varfërie më të lartë, ata që paraqesin këtë tregues në vlera më të ulëta se qarqet e tjera.

Tabela 3. Pesha e treguesve për çdo qark referuar mesatares së tyre në shkallë vendi

Nr	Qark	Popullsia	Niveli varfërisë / Mesatares kombëtare	Niveli i papunësisë/ Mesatares kombëtare	Të ardhurat lokale / Mesatares kombëtare	Aksesi furnizimit me ujë / Mesatares kombëtare	Niveli i numrit të vizitave mjeksore / Mesatares kombëtare	Plotesimi i arsimit të detyrueshëm/ Mesatares kombëtare	Treguesi i zhvillimit
		(numri)	%	%	%	%	%	%	
1	Berat	172,975	96	90	74.6	114	107	368	127,6
2	Dibër	143,650	59	121	61.4	54	70	55	65,3
3	Durrës	312,317	102	83	106	131	68	53	103,4
4	Elbasan	348,465	80	96	70	83	62	147	89,9
5	Fier	378,288	85	84	77	91	83	76	92,2
6	Gjirokastrë	103,287	131	95	112	97	132	385	142,1
7	Korçë	260,408	94	82	78	97	127	202	113,2
8	Kukës	75,765	63	237	74	91	56	54	62,1
9	Lezhë	160,094	69	173	78	58	89	162	77,3
10	Shkodër	249,331	77	189	67	74	120	75	73,2
11	Tiranë	803,909	108	53	160	123	140		130,8
12	Vlorë	152,846	139	100	139	132	92	506	160,2
	TOTAL	3.161.337							

Burimi: INSTAT, Treguesit sipas qarqeve 2006/2007, SNZHR⁸

Po kështu, mbi bazën e të dhënave statistikore për vitet 2006 e 2007, u bë vlerësimi i peshës që zënë treguesit e dendësisë së popullsisë dhe nivelit të papunësisë për çdo qark, kundrejt mesatares kombëtare për secilin nga këto vite. Tabela 4 paraqet këtë vlerësim, referuar edhe treguesit të llogaritur të nivelit të zhvillimit.

Tabela 4. Pesha që zënë për çdo qark treguesit e dendësisë së popullsisë dhe të papunësisë kundrejt mesatares kombëtare dhe treguesit të përgjithshëm të prapambetjes.

⁷ Publikim i INSTAT « Treguesit sipas qarqeve » për vitet 2006-2007

⁸ Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rajonal, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.773, datë 14.11.2007.

Nr.	Qark	Dendësia e popullsisë		Norma e Papunësia në %		Treguesi i zhvillimit
		2006	2007	2006	2007	
1	Berat	96	96	13.6	11.9	127,6
2	Dibër	56	56	17.1	16.0	65,3
3	Durrës	398	408	11.4	10.9	103,4
4	Elbasan	108	109	12.7	12.7	89,9
5	Fier	198	200	10.7	11.1	92,2
6	Gjirokastrë	36	36	12.2	12.6	142,1
7	Korçë	70	70	12.3	10.8	113,2
8	Kukës	33	32	31.6	31.3	62,1
9	Lezhë	98	99	23.0	22.8	77,3
10	Shkodër	69	70	25.8	25.0	73,2
11	Tirana	473	487	7.9	7.0	130,8
12	Vlorë	67	56	14.6	13.2	160,2
Mesatarja kombëtare		110	110	13.8	13.2	

Analiza e kryqëzuar e rezultateve të tabelës lë vend për diskutim. Nëse marrim në konsideratë të dhënat e dendësisë së popullsisë, si për vitin 2006, ashtu edhe për 2007, Kukësi, Gjirokastra, Dibra, Vlora dhe Shkodra shfaqen si qarqet me tregues më të ulët. Nga 2006 në 2007, vërehet një rritje e konsiderueshme e dendësisë së popullsisë për qarqet e Tiranës dhe të Durrësit (+3% e +4.9%). Përveç Vlorës, ku dendësia e popullsisë u ul me pothuajse 11% nga 2006 në 2007, prirja e këtij treguesi për 9 qarqet e tjera mbetet e pandryshuar.

Norma e papunësisë shfaqet në nivele të larta në Kukës, Shkodër dhe Lezhë për të dy vitet, edhe pse ky tregues në secilin nga këto qarqe ka pësuar një ulje të lehtë në vitin 2007, në krahasim me vitin 2006. Në terma të përgjithshëm, norma kombëtare e papunësisë në vitin 2007 ishte 13.2% kundrejt 13.8% për 2006. Në vitin 2007, edhe qarqet e tjera shfaqin një ulje të normës së papunësisë. Bëjnë përjashtim qarku i Elbasanit, që ka pasur një normë të njëjtë papunësie dhe qarqet e Gjirokastrës dhe Fierit, ku është vënë re rritje e nivelit të papunësisë.

Nëse kryejmë analizën e kryqëzuar për vitin 2006 dhe 2007 për treguesit e dendësisë së popullsisë dhe papunësisë vërehet se, përgjithësisht, ndryshimet janë në kah të kundërt. Në qarqet ku vërehet një rritje relative e dendësisë së popullsisë nga 2006 në 2007, kemi ulje respektive të normës së papunësisë.

Ky konstatim është i rëndësishëm në rastin kur duam të përcaktojmë se cilit qark do t'i jepet prioritet zhvillimi: Lezhës (si në SNZHR) ose Gjirokastrës (e cila radhitet e dyta me dendësi të popullsisë më të ulët) apo Vlorës, (e cila radhitet e treta së bashku me Dibrën për dendësi më të ulët).

Për të bërë këtë vlerësim, në analizën e përgjithshme duhet të marrim parasysh edhe analizën e treguesve të tjerë me peshë më të vogël. Konkretisht:

1. Bazuar në numrin e ndërmarrjeve (aktiviteteve) (shiko aneksin), qarqet e Gjirokastrës dhe Vlorës janë më të zhvilluara se qarku i Lezhës.

2. Përqindja e bizneseve të krijuara në qarkun e Gjirokastrës është e ulët, por norma e papunësisë është relativisht e ulët, kjo tregon se të dhënat e dendësisë së popullsisë dhe papunësisë influencohen nga turizmi sezonal.

3. Ndërsa norma zyrtare e papunësisë për Gjirokastrën është 12.6% (pothuajse gjysma e asaj të qarkut të Lezhës), norma e të papunëve të regjistruar për Gjirokastrën është 3% (1/3 e asaj të Lezhës dhe më e ulët se norma e Vlorës, e cila është afërsisht gjysma e Lezhës).


4. Pa paragjykuar për përcaktime në të ardhmen e rajoneve sipas NUTS II në Shqipëri, zgjedhja e Lezhës lejon përfshirjen edhe të 3 qarqeve të tjera, të cilat janë në vijimësi të njëri-tjetrit

brenda së njëjtës zonë. Megjithatë, të marra së bashku, 4 qarqet kanë një numër popullsie prej 628,839, që përbën 20% të popullsisë totale, por që nuk arrijnë numrin e përcaktuar nga NUTS II, prej 800,000 banorësh për rajon.

Pavarësisht vendimmarrjes së mëtejshme për përzgjedhjen e rajoneve sipas NUTS II, analiza e mësipërme tregon se qarkut të Lezhës duhet t'i jepet prioritet zhvillimi në krahasim me qarqet e Gjirokastrës dhe të Vlorës.

Figura 1 paraqet hartën e ndihmës shtetërore, të përgatitur në zbatim të legjislacionit në fuqi për ndihmën shtetërore, e cila konsideron si zona thellësisht të prapambetura, pra me intensitetin maksimal të ndihmës (65%), qarqet e Kukësit, Shkodrës, Lezhës dhe Dibrës.

Figura 1: Harta e ndihmës shtetërore për përcaktimin e zonave thellësisht të prapambetura për vitin 2009



Aneks

Të dhënat kryesore social-ekonomike në nivel kombëtar dhe për çdo qark

Treguesit	2006	2007
Popullsia	3.150.886	3.161.337
GDP (nominale në milion LEK)	896.300	956.314
GDP për frymë LEK	284.460	302.503
Sipërfaqja (Km/katror)	28 748	28 748
Dendësia e Popullsisë	110,00	110,00
Të papunë	149 794	142 871
Papunësia në %	13.8%	13.2%
SME	77 951	87 484
Ndërmarrje të reja	13 874	13 764

Burimi: INSTAT, Treguesit sipas qarqeve 2006/2007

BERAT





Të dhënat

Treguesi	2006	2007	Burimi	Shënime
Popullsia (banorë)	172 953	172 975	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
GDP (nominale në LEK)				N A
GDP për frymë				N A
Sipërfaqja (km/katror)	1798	1798	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
Dendësia e popullsisë (banorë/km)	96	96	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	
Të papunë	9810	8468	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë afatgjatë në %	12,9	11,1		të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë në %	13,6	11,9	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	
Nr i SME-ve (ndërmarrje)	3011	3554	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	Përkufizimi i BE-së
Nr i SME-ve ndaj nr të SME-ve gjithsej në %	3,9	4,1		
Ndërmarrje të reja	592 (4.3%)	769 (5.6%)	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006	

DIBËR





Të dhënat

Treguesi	2006	2007	Burimi	Shënime
Popullsia (banorë)	144 598	143 649	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
GDP (nominale në LEK)				N A
GDP për frymë				N A
Sipërfaqja (km/katror)	2586	2586	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
Dendësia e popullsisë (banorë/km)	56	56	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006,	
Të papunë	9687	8951	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë afatgjatë në %	15,6	14,6		të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë në %	17,1	16	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006,	
Nr i SME-ve (ndërmarrje)	1173	1395	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	Përkufizimi i BE-së
Nr i SME-ve ndaj nr të SME-ve gjithsej në %	1,5	1,6		
Ndërmarrje të reja	276 (2%)	381 (2.8%)	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006	

DURRES





Të dhënat

Treguesit	2006	2007	Burimi	Shënime
Popullsia (banorë)	304 592	312 317	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
GDP (nominale në LEK)				N A
GDP për frymë				N A
Sipërfaqja (km/katror)	766	766	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
Dendësia e popullsisë (banorë/km)	398	408	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	
Të papunë	8109	7923	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë afatgjatë në %	10,7	8,3		të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë në %	11,4	10,9	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006,	
Nr i SME-ve (ndërmarrje)	9481	10624	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	Përkufizimi i BE-së
Nr i SME-ve ndaj nr të SME-ve gjithsej në %	12,2	12,1		
Ndërmarrje të reja	2083 (15%)	1568 (11.4%)	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006	

FIER





Të dhënat

Treguesit	2006	2007	Burimi	Shënime
Popullsia (banorë)	374948	378288	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
GDP (nominale në LEK)				N A
GDP për frymë				N A
Sipërfaqja (km/katror)	1890	1890	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
Dendësia e popullsisë (banorë/km)	198	200	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	
Të papunë	15181	16096	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë afatgjatë në %	9,9	7,9		të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë në %	10,7	11,1	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006,	
Nr i SME-ve (ndërmarrje)	7777	8321	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	Përkufizimi i BE-së
Nr i SME-ve ndaj nr të SME-ve gjithsej në %	10	9,5		
Ndërmarrje të reja	1101 (7.9%)	1115 (8.1%)	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006	

GJIRKASTER





Të dhënat

Treguesit	2006	2007	Burimi	Shënime
Popullsia (banorë)	103690	103287	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
GDP (nominale në LEK)				N A
GDP për frymë				N A
Sipërfaqja (km/katror)	2884	2884	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
Dendësia e popullsisë (banorë/km)	36	36	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	
Të papunë	4261	4294	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë afatgjatë në %	10,4	11,1		të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë në %	12,2	12,6	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006,	
Nr i SME-ve (ndërmarrje)	2852	2493	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	Përkufizimi i BE-së
Nr i SME-ve ndaj nr të SME-ve gjithsej në %	3,7	2,8		
Ndërmarrje të reja	253 (1.8%)	222 (1.6%)	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006	

KORÇE





Të dhënat

Treguesit	2006	2007	Burimi	Shënime
Popullsia (banorë)	258100	260408	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
GDP (nominale në LEK)				N A
GDP për frymë				N A
Sipërfaqja (km/katror)	3711	3711	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
Dendësia e popullsisë (banorë/km)	70	70	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	
Të papunë	10460	9362	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë afatgjatë në %	10,8	8,8		të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë në %	12,3	10,8	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006,	
Nr i SME-ve (ndërmarrje)	6316	6875	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	Përkufizimi i BE-së
Nr i SME-ve ndaj nr të SME-ve gjithsej në %	8,1	7,9		
Ndërmarrje të reja	853 (6.1%)	927 (6.7%)	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006	

KUKES






Të dhënat

Treguesit	2006	2007	Burimi	Shënime
Popullsia (banorë)	78239	75765	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
GDP (nominale në LEK)				N A
GDP për frymë				N A
Sipërfaqja (km/katror)	2374	2374	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
Dendësia e popullsisë (banorë/km)	33	32	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	
Të papunë	11797	11435	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë afatgjatë në %	30,8	27,4		të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë në %	31,6	31,3	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006,	
Nr i SME-ve (ndërmarrje)	676	764	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	Përkufizimi i BE-së
Nr i SME-ve ndaj nr të SME-ve gjithsej në %	0,9	0,9		
Ndërmarrje të reja	300 (2.2%)	154 (1.1%)	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006	

SHKODER





Të dhënat

Treguesit	2006	2007	Burimi	Shënime
Popullsia (banorë)	247394	249331	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
GDP (nominale në LEK)				N A
GDP për frymë				N A
Sipërfaqja (km/katror)	3562	3562	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
Dendësia e popullsisë (banorë/km)	69	70	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	
Të papunë	22701	22168	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë afatgjatë në %	22	22,8		të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë në %	25,8	25	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
Nr i SME-ve (ndërmarrje)	3556	4323	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	Përkufizimi BE-së
Nr i SME-ve ndaj nr të SME-ve gjithsej në %	4,60	4,90		
Ndërmarrje të reja	1240 (8.9%)	715 (5.2%)	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006	

TIRANE





Të dhënat				
Treguesit	2006	2007	Burimi	Shënime
Popullsia (banorë)	781087	803909	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
GDP (nominale në LEK)				N A
GDP për frymë				N A
Sipërfaqja (km/katror)	1652	1652	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
Dendësia e popullsisë (banorë/km)	473	487	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	
Të papunë	20232	17756	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë afatgjatë në %	7,7	5,9		të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë në %	7,9	7	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006,	
Nr i SME-ve (ndërmarrje)	30172	34131	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	Përkufizimi i BE-së
Nr i SME-ve ndaj nr të SME-ve gjithsej në %	39	39		
Ndërmarrje të reja	5111 (36.8%)	4961 (36%)	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006	

VLORE				
				
Të dhënat				
Treguesit	2006	2007	Burimi	Shënime
Popullsia (banorë)	181996	152847	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
GDP (nominale në LEK)				N A
GDP për frymë				N A
Sipërfaqja (km/katror)	2706	2706	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë	
Dendësia e popullsisë (banorë/km)	67	56	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	
Të papunë	7300	6372	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë afatgjatë në %	13,3	12,1		të papunë të regjistruar
Niveli i papunësisë në %	14,6	13,2	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006,	
Nr i SME-ve (ndërmarrje)	6162	6826	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006, 2006/2007	Përkufizimi i BE-së
Nr i SME-ve ndaj nr të SME-ve gjithsej në %	7,9	7,8		
Ndërmarrje të reja	914 (6.6%)	1040 (7.6%)	Treguesit e INSTAT për çdo Prefekturë 2005/2006	

VENDIM
Nr.788, datë 27.3.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KOMBËTAR
“TV KLAN”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv”, dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv kombëtar privat “TV Klan”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.789, datë 27.3.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO EGNATIA”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv”, vendimit nr.766, datë 30.1.2009 dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Egnatia”, për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 14.12.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Mesila Doda (Demi)

KËRKESË

Shtetasi Emiljano Dika, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasit Veri Dika, dhe caktimin si kujdestare për administrimin e pasurisë, gruan e tij, Trëndeline Dika.

KËRKUESI
Emiljano Dika

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë

Hyri në shtyp më 6.5.2009
Doli nga shtypi më 6.5.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADELPRINT
Tiranë, 2009

Çmimi 28 lekë